

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në çështjen penale të akuzuarit T. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.884/2014 të datës 24.04.2015, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit Shtetit Arijana Shajkovci, të akuzuarit, dhe Kadri Ademi zyrtar ligjor – përfaqësues i autorizuar i dëmtuarës Hidroregjioni Jugor në Prizren, me datë 23.09.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

T. K. nga i ati N. dhe e ëma Z. e lindur K., i lindur me datë ... në fshatin L. Komuna e M., tani me banim në Prizren, ka të kryer shkollën e lartë pedagogjike, gjuhë dhe letërsi shqipe – arsimtar, i martuar baba i pesë fëmijëve, me numër personal ..., i gjendjes së pasur ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 03.04.2014, në Prizren në rrugën “J. G.”, me qëllim që vetit t’i sjellë pasuri të kundërligjshme, merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga rrjeti i ujësjellësit në mënyrë të pa autorizuar, në atë mënyrë që i pandehuri është lidhur ilegalisht në rrjetin e ujësjellësit pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar e cila është konstatuar nga personat e autorizuar të Njësisë Punuese të Prizrenit të cilës Kompanisë Rajonale të ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor”, i sjellë dëm material në shumën prej 4,176.00 (katër mijë e njëqind e shtatë dhjetë e gjashtë) €.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 45, 46, 49, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 7 (shtatë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afati prej 1 (një) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësorë në shumën prej 50 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.884/2014 të datës 24.04.2015, kundër të akuzuarit T. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Përfaqësuesi i aktakuzës – Prokurori Shtetit Arijana Shajkovci në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron pranë aktakuzës së parashtruar, kundër të akuzuarit të lartpërmendur, duke kërkuar nga gjykata t’ia fal besimin e plotë provave materiale, të shkyçjes e datës 03.04.2014, deklaramit të anëtarëve të komisionit, të cilët në ditën kritike kanë qenë në vendin e ngjarjes, poashtu edhe gjatë dëgjimit të dëshmitarit A. M. në procedurën e provave ka deklaruar se nuk kemi të bëjmë me ujë të vadës, por uji i shfrytëzuar i përket kompanisë së Hidroregjionit, meqenëse në përmbajtjen e saj ka pasur klor dhe pas sigurimit se nuk ekziston asnjë pëlqim nga kompania për vendosjen e gypit të profilit me numër 063, e cila është hasur në pronën e të akuzuarit, i cili ka qenë i vendosur mbi tokë dhe në shfrytëzim të konsumatorit – akuzuarit. Andaj, nga gjykata ka kërkuar që pas vlerësimit të të gjithë provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor të akuzuarin të e shpall fajtor dhe të njëjtin të e dënojë konform dispozitave të KPK.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurorit të shtetit, pasi që në rastin konkret bëhet fjalë për kyqje ilegale të përshkruar sipas aktakuzës, ndërsa në anën tjetër ka parashtruar kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit T. K.

I akuzuari T. K. në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se ai të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barë, pasi që nga provat e administruar, dëshmitarëve të propozuar nga ai si A. Q. dhe H. K., kanë paraqitur në mënyrë të detajuar gjendjen në teren e të cilat deklarata përputhen e edhe me provat e tjera materiale të propozuara, pra, se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me asnjë keqpërdorim nga ana e tij. Në vazhdim ka theksuar se gypat në pronën e tij kanë qenë të vendosura më herët, para se ai të blinte këtë paluajtshmëri, ndërsa në rastin konkret nga organi i akuzës nuk janë bërë të gjitha përpjekjet për përshkrimin e gjendje reale në vendin e ngjarjes, lidhur harxhimin e ujit dhe cilësisë së saj, duke potencuar se qëllim i tij nuk ka qenë të keqpërdori ujin, pasi që financiarisht qëndron mirë dhe bizneset e tij në këtë vend punojnë me ujë të vades, konkretisht pishina e tij e mbush nga burimet e tjera siç janë bunari, ndërsa kopshtet dhe parqet të cilat gjenden përreth pronës së tij të cilat janë në sipërfaqe rreth 4 hektar ujiten nga uji i vades. Andaj, duke i marrë parasysh të gjitha këto rrethana, ka propozuar gjykatës që në mungesë të provave të e lirojë nga përgjegjësia penale dhe ndaj tij të shqiptohet aktgjykim lirues.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

I akuzuari pronën e tij e cila gjendet në rrugën “J. G.” në Prizren, gjatë vitit 2013 e kishte blerë në një proces të privatizimit, e cila pjesë para procesit të privatizim ka qenë një zonë industriale, në të cilën ishin të ndërtuara shtalla e qytetit, të cilat objekte kanë qenë të lidhura në rrjetin e ujësjellësit. Në vitin 2014, i akuzuari në këtë pjesë kishte filluar ndërtimin e objekteve – shtëpi banimi, mirëpo, në ditën kritike me datë 03.04.2014, shtëpitë e ndërtuara

nga i akuzuari ishin rrënuan nga ana inspektorëve komunal, po atë ditë nga ana punëtorëve të autorizuar të Kompanisë Regionale të ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” është konstatuar se i akuzuari është lidhur ilegalisht në rrjetin e ujësjellësit pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar me qëllim që vetit t’i sjellë pasuri të kundërligjshme, duke marr, përdorur, devijuar, dhe përfitur nga shërbim komunal që furnizohet nga rrjeti i ujësjellësit, duke i sjellë dëme materiale “Hidroregjionit Jugor” në shumën prej 4,176.00 (katër mijë e njëqind e shtatë dhjetë e gjashtë) €. Nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit T. K. më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

I akuzuari T. K., gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar aktakuzën e prokurorit të shtetit, duke theksuar se nuk është fajtor për veprën penale e cila vihet në barrë. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se në ditën kritike nuk ka qenë në vendin e ngjarjes, por ka qenë në vendin e tij të punës në lokalin “T.”, pasi që ka pasur informacione se po atë ditë do të bëhet rrënimi i shtëpive të tij, ndaj edhe qëllimi i tij ka qenë që të mos prezantohet aty, por njërin prej anëtarëve të komisionit e ka takuar në vendin e punës, të cilën e njeh dhe nga ai ka kuptuar se zyrtarët e Hidroregjionit Jugor - anëtarët e komisionit kanë ardhur për intervenimin në ujë, të cilët me atë rast edhe kanë përpiluar procesverbalin e vendit të ngjarjes të datës 03.04.2014, në ora 13:00. Në vazhdim ka theksuar se procesverbali i përpiluar nga anëtarët e komisionit i është prezantuar atij, por të njëjtën e ka refuzuar që ta nënshkruajë, pasi që nuk është pajtuar me atë konstatim, mirëpo ankesë të veçantë nuk ka bërë. Ndërsa, gjatë asaj dite ka qenë i preokupuar me probleme të tjera rreth rrënimit të shtëpive, dhe në fakt atë ditë nuk ka ditur se për çfarë gypi bëhet fjalë, duke theksuar pas privatizimit të tokave nga ana e tij, ka pasur dijeni se në ato pjesë ka pasur sistem të ujit, sepse aty kanë qenë shtalla e qytetit, të cilat janë pajisur me ujë, por se ky gyp nuk ka qenë i shtallës e ka kuptuar më vonë dhe atë gjatë gjykimit. Më tej ka theksuar se nga Hidroregjioni Jugor nuk ka kërkuar leje për kyqje, pasi që në atë vend ekzistojnë edhe burime të tjera të ujit siç janë: uji i vadës dhe uji i bunarit, por gjithashtu në këtë vend përpos këtyre burimeve ka pasur edhe sistem legal me orë matës nga Hidroregjioni Jugor. Ndërsa, në fund ka potencuar se gypi kontestuese i profilit 63/m3, i cili shkon në punishten e komshiut A. Q. dhe i cili ka ujë matës, ndërsa në gypi të cilën aludohet se është bërë kyqja është një copë në të cilën është intervenuar (sanuar), nga ana e punëtorit të tij që është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, pasi që të njëjtën e ka këputur eskavatori gjatë punimeve, ndërsa ujin e sistemit në këtë rast nuk e ka përdorë, pasi që se shtëpitë të cilat i ka ndërtuar janë bërë me material të gatshëm, dhe ujin të cilin e ka përdoruri në terren ka qenë ujë i vades dhe i burimit, pasi që i njëjti është më afër vendit të punishtes dhe është pa pagesë, ndërsa ujin e ujësjellësit është larg vend punishtes.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat: deklaratën e përfaqësuesit të dëmtuarit Kadri Ademi, dëgjimin e dëshmitarëve: N. B., H. K., A. M., A. Ç., H. K., është bërë leximi i provave materiale dhe atë: fatura me numër 01/2014 të datës 04.04.2014, procesverbali mbi shkyqjen e konsumatorit e datës 03.04.2014, foto dokumentacioni i ofruar nga prokurori i shtetit në katër faqe, foto dokumentacioni mbi vendin e ngjarjes e fotografuar nga ana e T. K. në 13 faqe, konkluzioni i lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Inspektorateve me numër 17-354-21-3 të datës 01.04.2014, dy fotografi të ofruara nga i akuzuari.

Gjykata pas administrimit të provave veç e veç dhe pas vlerësimit të tyre nuk ka pranuar mbrojtjen e akuzuarit T. K., se nuk është fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, me arsyetimin gypin me të cilin pretendohet se është bërë kyqja është një copë në të cilën është intervenuar (sanuar), nga ana e punëtorit të tij, pasi që të njëjtën e kishte këputur eskavatori gjatë punimeve, ndërsa në këtë rast ujin e rrjetit të ujësjellësit nuk e ka përdorë, pasi që shtëpitë të cilat i ka ndërtuar janë bërë me material të gatshëm, dhe ujin të cilin e ka përdoruri në terren ka qenë ujë i vades dhe i burimit, sepse i njëjti është më afër vendit të punishtes së tij dhe është pa pagesë, ndërsa uji i sistemit të ujësjellësit është larg vend punishtes. Gjykata nuk i kushtoj besim deklaratës së akuzuarit, pasi që mbrojtja e këtillë nuk

është e pranueshme dhe bindëse për gjykatën, strategjia e këtillë e mbrojtjes nuk është e pranueshme sepse ai ka për qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale të tij, dhe e njëjtë është në kundërshtim me provat materiale: fatura me numër 01/2014 të datës 04.04.2014, procesverbali mbi shkyqjen e konsumatorit e datës 03.04.2014, foto dokumentacioni, nga dëgjimi i dëmtuarit K. A., dëshmitarëve N. B., H. K., A. M., të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës dhe të cilat në tërësi dëshmojnë të kundërtën.

Në të vërtetë, arsyetim i dhënë nga ana e të akuzuarit në këtë drejtim nuk është bindëse për gjykatën, kjo për faktin se i akuzuari pronën të cilën e ka blerë në vitin 2013, gjatë një procesi të privatizimit ka pasur njohuri se ajo pjesë më herët ka qenë zonë industriale e qytetit, në të cilën kanë qenë të ndërtuara shtallat e qytetit, dhe të cilat objekte kanë qenë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit. Kjo e arsyeton faktin se i akuzuari me rastin e rrënimit të këtyre objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të banimit – shtëpive, gjatë punimeve ka dëmtuar rrjetin e ujësjellësit me eskavator, dhe për këtë fakt i njëjti asnjëherë nuk ka lajmëruar organet kompetente, gjegjësisht Kompania Rajonal e Ujësjellësit, Hidroregjionit Jugor, në Prizren, por i njëjti ka vazhduar me veprimet e tij të kundërligjshme duke intervenuar në atë pjesë të gypit të ujësjellësit dhe ka bërë lidhje të kundërligjshme për shfrytëzimin e ujit të rrjetit të ujësjellësit. Prandaj, edhe pretendimi i të akuzuarit se nuk ka bërë kyqje ilegale në rrjetin e ujësjellësit, sepse për shfrytëzimin e atij uji nuk ka pasur nevojë, pasi që ka përdorur ujin e vades dhe të bunarit, sipas vlerësimit të gjykatës kjo nuk mund të qëndrojë, sepse mbrojtja e tillë nuk ka asnjë bazë juridike, pasi që nuk është arsyetuar me asnjë provë relevante.

Në këtë drejtim, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka administruar provat të cilat në rastin konkret kanë ndihmuar gjetjen e vërtetës dhe ndriçimin e rastit dhe atë me dëgjimin e dëshmitarit – përfaqësuesit e autorizuar të dëmtuarit Kadri Ademi, i cili ka deklaruar se pranë kësaj kompanie bazuar në ligjet dhe rregulloren e punës ekziston shërbimi i kontrollit të konsumatorëve, ashtu që çdo konsumatorë mund të bëjë kërkesë për një kontroll nëse mendon se diçka në instalimin në objektin e tij është keqpërdorur, por këto kontrolla kryen edhe sipas detyrës zyrtare, e me qëllimin e kontrollit të llojeve të ndryshme të keqpërdorimeve nga rrjetit i ujësjellësit deri te ujë matësi e deri tek instalimet brenda në objekt të konsumatorit, të cilat kontrolla kryen nga ana e kompanisë, gjegjësisht punëtorëve të cilët janë të emëruar nga ana e organeve të kompanisë dhe veprojnë në terren si ekip i kontrollit, të cilët evidentojnë mangësitë, keqpërdorimet që bëhen në situata të ndryshme. Po ashtu, Kompania Regjionale “Hidroregjioni Jugor” në Prizren, është përgjegjëse për eliminimin e defekteve në rrjetin e furnizimit deri tek ujë matësi, të cilat defekte eliminohen me shpenzime të kompanisë, ndërsa defektet prej ujë matësit në brendësi të rrjetit e cila gjendet në objektin e konsumatorit këto defekte eliminohen me shpenzimet e konsumatorit, deri tek pika e fundit të furnizimit. Përveç kësaj, çdo defekt që haset nga ana e ekipit të kontrollit, me atë rast përpilohet procesverbali në të cilat evidentohet keqpërdorimet, emri i konsumatorit, emri i anëtarëve të grupit kontrollues dhe i cili procesverbal nënshkruhet nga ana e punëtorëve në terren. Në vazhdim ka theksuar se në rastet kur bëhet kyqja në rrjet nga ana e konsumatorit dhe nëse ky rast është lajmëruar në kompani, atëherë ky rast evidentohet dhe shiqohet se a është bërë keqpërdorim, dhe në pajtim me konsumatorin arrihet marrëveshja dhe bëhet kërkesa për kyqje legale si dhe regjistrimin e konsumatorit sipas dispozitave ligjore të kompanisë, pagimi i taksave dhe dëmi i shkaktuar – dëm i supozuar, ndërsa në raste kur kjo kyqje zbulohet nga ana e ekipit kontrollues siç është në rastin konkret kjo kategori ka tretman ndryshe, dhe çdo keqpërdorim i ujit nga ana e konsumatorit pa ujë matës e që nënkupton edhe pa leje është keqpërdorim, dhe konsiderohet si kyqje ilegale.

Në këtë drejtim, edhe nga deponimet e dëshmitarit N. B. – punëtor i kontrollit në Hidroregjionin Jugor, ka përshkruar dhe treguar tërë situatën në vendin e ngjarjes të cilat janë konstatuara në ditën kritike. Dëshmitari ka theksuar se në ditën kritike si udhëheqës i ekipit të komisionit kontrollues, me urdhërin e menaxherit kanë shkruar për kontroll në rrugën “J. G.”, tek shtëpia e konsumatorit – akuzuarit për verifikimin e pikës matëse. Fillimisht, gjatë

inspektimit të vendit të ngjarjes kanë vërejtur disa shtëpi të rrënuara, dhe me rastin e kontrollimit të gjendjes në teren është vërejtur se i akuzuari ishte lidhur në mënyrë ilegale nga rrjeti kryesor me një gyp në gjerësi 2 fi, në gjatësi prej 50-60 metra, e cila ka sjellë ujin deri në oborrin e tij, në të cilën lidhje nuk ka pasur ujë matës, dhe me atë rast nga ana e tyre si ekip kontrollues është bërë shkyçja e saj nga rrjeti kryesor, duke e këputur gypin e lidhur në mënyrë ilegale në të cilën ka qenë i vendosur edhe një ventil për lëshimin e ujit, dhe me atë rast është bërë edhe mbylljen e gypit kryesor. Gjithashtu, për këto të gjetura është përpiluar edhe procesverbali ku janë të evidentuar gjendja e konstatuar në vendin e ngjarjes, pra të gjitha parregullsitë, ndërsa llogaritjen e dëmit është bërë nga ana e shërbimit kompetent pranë kësaj kompanie. Gjithashtu, edhe nga dëgjimi i dëshmitari H. K., punëtor i kontrollit pranë Kompanisë Rajonale të Hidroregjionit Jugor në Prizren, i ka përshkruar të gjeturat në vendin e ngjarjes gjatë inspektimit në ditën kritike, në të cilën në deklaratën e tij ka theksuar me rastin e rrënimit të shtëpive të akuzuarit, inspekcioni komunal ka vërejtur një gyp fi 63 mbi tokë, dhe me atë kanë kërkuar që Kompania Regjionale e Hidroregjionit Jugor të intervenohet në vendin e ngjarjes, dhe me atë rast pas inspektimit të terrenit dhe sipas mjeteve të tyre kanë bërë kontrollimin e ujit se cilës kategori i takon, dhe pasi që është konstatuar si uji nga ky gyp është i pijes dhe i takon rrjetit të ujësjellësit, atëherë nga gypi kryesor është bërë ndërprerje e gyp shtesë me ngjyrë të verdhë, në gjatësi prej 50 metrave, e cila ishte vendosur deri tek shtëpia e të akuzuarit, në të cilën ka pasur ventil, por pa orë matëse. Ndërsa, sipas rregullores së brendshme të kompanisë, llogaritja e dëmit në rastet e konsumatorëve të pandërgjegjshme që bëjnë lidhje ilegale, për një qesme ngarkohet me 2000 m/kub ujë, për harxhim paushall, dhe në rastin konkret pasi që tek konsumatori kanë qenë të ndërtuara 5 shtëpi kjo shumë është shumëzuar për 5 herë. Edhe nga deklarata e dëshmitarit A. M., punëtor i ekipit kontrollues në Hidroregjionin Jugor, i cili poashtu ka përshkruar në mënyrë identike të gjeturat në ditën kritikë sikurse dëshmitarët N. B. dhe H. K. dhe i njëjti ka qëndruar pranë procesverbalit të datës 03.04.2014, i përpiluar në ditën kritike dhe foto dokumentacioni i bërë gjatë kontrollës tek prona e të akuzuarit. Po kështu, edhe nga dëgjimi i dëshmitarit A. Ç., i cili është fqinj me të akuzuarin, ka theksuar se në pronën e tij ka ndërtuar një objekt thertores, pasi që me profesion është kasap, dhe pas kërkesës së tij në kompaninë e ujësjellësit është lidhur në rrjetin e ujësjellësit në mënyrë ligjore nga ana e kësaj kompanie, nëpër një gyp i cili kalon në pronën e të akuzuarit dhe përpos tij në këtë gyp është i lidhur edhe i akuzuari T. K. dhe tre komshi të tij.

Gjykata në shqyrtimin kryesor gjatë administrimit të provave ka administruar edhe provat materiale të propozuara në aktakuzë: dhe atë procesverbali mbi shkyqjen e konsumatorit e datës 03.04.2014, dhe fatura me numër 01/2014 të datës 04.04.2014, në të cilën gjykata ka vërtetuar se komisionit kontrollues në vendin e ngjarjes ka konstatuar se i akuzuari T. K. në rrugën J. G., në amvisërin e tij pa pëlqimin e Hidroregjionit Jugor ka bërë kyqje ilegale në rrjetin e ujësjellësit me gypin pvc me profil prej 63/m3, dhe si pasojë e kësaj lidhje joligjore kompanisë i ka shkaktuar shpenzim të 10000 m3 ujë në vlerë prej 4176 euro. Po kështu edhe nga foto dokumentacioni prej 4 faqes, e cila është bërë nga ana e komisionit kontrollues në vendin e ngjarjes, shihen pamjet e shtëpive të rrënuara në pronësi të akuzuarit, si dhe vendi në të cilën është zbuluar gypi i lidhur në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të akuzuarit.

Pra nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara del se i akuzuari në pronën e tij e cila gjendet në Prizren rrugën “J. G.”, e kishte blerë në procesin e privatizimit gjatë vitit 2013. I akuzuari ka pasur njohur të mirë se kjo pjesë blerë (para privatizimit) ka qenë pjesë industriale e qytetit, në të cilën kanë qenë të ndërtuara objektet – shtallat e qytetit, dhe në këtë pjesë ka ekzistuar rrjeti i ujësjellësit. Prandaj, i akuzuari duke e ditur këtë fakt e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, pa marrë leje nga furnizuesi i autorizuar Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjionit Jugor në Prizren, lidhet në rrjetin e ujësjellësit në mënyrë të pa autorizuar përmes një gypi në gjerësi prej 2 fi, në gjatësi prej 50-60 metra, duke e sjellë ujin e rrjetit të ujësjellësit deri në oborrin e tij, në të cilën lidhje nuk ka pasur ujë

matës për harxhimin e ujit, duke i shkaktuar dëme materiale kompanisë së ujësjellësit, të cilat fakte janë konstatuara me rastin e kontrollimit në ditën kritike nga ana e ekipit kontrollues.

Të gjitha këto fakte vërtetohen nga deklaratat e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit Kadri Ademi, e dëshmitarëve N. B., H. K., A. M., A. Ç., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të cilat janë plotësisht në pajtim me provat materiale e sidomos me fatura me numër 01/2014 të datës 04.04.2014, procesverbali mbi shkyqjen e konsumatorit e datës 03.04.2014, foto dokumentacioni i ofruar nga prokurori i shtetit në katër faqe. Pra në këtë rast gjykata ka vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të akuzuarit, pasi që i akuzuara ka qenë e vetëdijshme se me veprimet e tij të kundërligjshme, duke u lidhur në mënyrë të paautorizuar në rrjetin e ujësjellësit, ka pasur për qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurore për vete nga shfrytëzimi i shërbimit komunal.

Sa i përket deklaratës së dëshmitarit H. K., në deponimin e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, i cili ka qenë edhe prezent në ditën kritike, ka deklaruar se tek i akuzuari punon si mirëmbajtës teknik për 11 vite në firmën T., dhe gjatë kohës së ndërtimit të shtëpive i akuzuari ka përdorur material të gatshëm nga prodhuesit, ashtu që uji është përdorur shumë pak nga ana e të akuzuarit dhe atë për nevojat personale nga banjoja e cila është afër vendit të ndërtimit, i cili ujë është i pusit (bunarit), ndërsa në këtë pjesë përpos këtij uji përdoret edhe uji i vadës. Po ashtu, në këtë pjesë ekzistojnë shumë gypa të ujësjellësit pasi që më herët ka qenë zonë industriale, dhe gjatë ndërtimit të shtëpive është hasur në shumë gypa të ujësjellësit të cilat gjatë punës i kanë sanuar vetë, duke i mbyllur me shtopne me qëllim që të mos rrjedh uji, e kështu është vepruar edhe me gypin kontestuese e cila është konstatuar në ditën kritike nga kontrollat, ajo ka qenë e dëmtuar dhe e njëjta është sanuar me qëllim që të mos rrjedh uji nëpër tokë, por njëkohësisht ka qenë edhe gypi i komshiut A. Q. i cili ka thertoren afër. Gjykata deponimit të dëshmitarit nuk ia fali besimin, pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e marrjes në pyetje nga ana e gjykatës nuk ka qenë bindës - është në kundërshtim me deklaratimet e dëshmitarëve Kadri Ademi, N. B., H. K., A. M., A. Ç., si dhe provave materiale dhe atë nga procesverbali mbi shkyqjen e konsumatorit e datës 03.04.2014, foto dokumentacioni.

Gjykata nuk i kushtoj besim provave të propozuar nga ana e akuzuarit – dhe atë fotoalbumit prej 15 faqesh, sepse nga këto foto gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se gypi i cili ka qenë i lidhur ilegalisht nga i akuzuari në rrjetin e ujësjellësit nuk është përdorur nga ana e tij. Në anën tjetër, nga prova konkluzioni i lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Inspektorateve me numër 17-354-21-3 të datës 01.04.2014, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë asnjë fakt të rëndësishëm, dhe e njëjta ishte irelevante për çështjen objekt kontesti.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në rastin konkret gjykata nuk gjeti rrethana rënduese ndërsa si rrethana lehtësuese është marrë parasysh faktin se i akuzuari ka qenë korrekt gjatë zhvillimit të procedurës, gjendja familjare të tij, është baba i pesë fëmijëve, gjer më tani nuk ka qenë i gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se dënimi është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.898/2015 të datës 23.09.2016

B. Profesional
Arlind Sharani

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHEZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.